



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-CC-2024-26

Vendos: Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese

Gjykatës Vidar Stensland, Kryetar

Gjykatës Roumen Nenkov

Gjykatëse Romina Inkuti

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 25 shtator 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët për Zgjatje të Afatit

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Viktimave

Ani Puz

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykses I lëshoi Aktgjykimin, me të cilin e shpalli fajtor z. Salih Mustafa për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje si krime lufte dhe e shpalli të pafajshëm për krimin e luftës të trajtimit mizor.¹ Trupi Gjykses e dënoi z. Mustafa me 26 vite burgim.²

2. Më 14 dhjetor 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit shqiptoi Aktgjykimin e Apelit, me të cilin la në fuqi vendimet e fajësisë së z. Mustafa për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje si krime lufte, por miratoi pjesërisht apelin e z. Mustafa kundër dënimit të tij.³ Për këtë qëllim, Paneli i Gjykatës së Apelit e uli dënimin e z. Mustafa në 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.⁴

3. Më 29 korrik 2024, Paneli i Gjykatës Supreme miratoi pjesërisht kërkesën e z. Mustafa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe e ktheu Aktgjykimin e Apelit në Panelin e Gjykatës së Apelit vetëm për aq sa kishte të bënte me vendimin e ri për dënimin e z. Mustafa me 22 vite burgim ("Vendimi i Panelit të Gjykatës Supreme").⁵

4. Më 10 shtator 2024, duke pasur parasysh vendimin e Panelit të Gjykatës Supreme, Paneli i Gjykatës së Apelit e uli dënimin e z. Mustafa në 15 vite burgim ("Vendimi i Panelit të Gjykatës së Apelit").⁶

5. Më 20 shtator 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS) dhe mbrojtësja e viktimave në çështjen kundër z. Mustafa paraqitën një kërkesë të përbashkët për zgjatjen e afatit për të bërë kërkesa referuese në përputhje me nenin 49 të Ligjit nr.

¹ KSC-BC-2020-05, F00494, Aktgjykim, 16 dhjetor 2022, konfidencial ("Aktgjykimi"), para. 831. Versioni i korrigjuar u lëshua më 24 janar 2023, F00494/COR, ndërsa versioni i redaktuar publik më 8 qershor 2023, F00494/RED3/COR.

² Aktgjykimi, para. 831.

³ KSC-CA-2023-02, F00038, Aktgjykimi i Apelit, 14 dhjetor 2023, konfidencial ("Aktgjykimi i Apelit"), para. 484. Versioni i redaktuar publik u lëshua më atë ditë, F00038/RED.

⁴ Aktgjykimi i Apelit, para. 484.

⁵ KSC-SC-2024-02, F00018, Vendim mbi Kërkesën e Salih Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 29 korrik 2024, publik.

⁶ KSC-CA-2023-02, F00045, Vendim për Lëshimin e një Vendimi të Ri Dënimi për Salih Mustafën, 10 shtator 2024, publik.

05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") në lidhje me vendimin e lëshuar nga Paneli i Gjykatës Supreme për dënimin me burg të z. Mustafa ("Kërkesa e Përbashkët").⁷

6. Më 23 shtator 2024, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, në pajtim me nenin 33(3) të Ligjit caktoi Panelin e mësipërm për të vendosur për Kërkesën e Përbashkët dhe çdo çështje tjetër të lidhur me të.⁸

II. PARASHTRIMET

7. ZPS-ja dhe mbrojtësja e viktimave pretendojnë se për ta zbatohen afate të ndryshme lidhur me parashtrimin e një kërkesë referuese para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("DHSGJK") sa i takon Vendimit të Panelit të Gjykatës Supreme dhe Vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit pas tij, që rezultoi në uljen e dënimit të z. Mustafa me 15 vite burgim.⁹ ZPS-ja dhe mbrojtësja e viktimave parashtrojnë se, nëse afati për paraqitjen e parashtrimeve do të sinkronizohej për të dyja palët, kjo do të mundësonte kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit dhe do të ndihmonte në administrimin efikas të çështjes.¹⁰ ZPS-ja dhe mbrojtësja e viktimave argumentojnë se kjo përbën arsye të vlefshme për shtyrjen e afatit për paraqitjen e kërkesave të tyre referuese.¹¹ Rrjedhimisht, ZPS-ja dhe mbrojtësja e viktimave kërkojnë, në përputhje me rregullën 6(4) të Rregullores së Procedurës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Rregullorja e DHSGJK"), që DHSGJK-ja të zgjatë afatet për paraqitjen e kërkesave të tyre referuese përkatëse deri më 11 nëntor 2024.¹²

III. KUVENDIMET

⁷ KSC-CC-2024-26, F00001, Kërkesë e Përbashkët për Zgjatje të Afatit, 20 shtator 2024, publik.

⁸ KSC-CC-2024-26, F00002, Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese, 23 shtator 2024, publik.

⁹ Kërkesa e Përbashkët, para. 1-3.

¹⁰ Kërkesa e Përbashkët, para. 3. *Shih gjithashtu*, Kërkesën e Përbashkët, para. 4.

¹¹ Kërkesa e Përbashkët, para. 1.

¹² Kërkesa e Përbashkët, para. 1.

8. DHSGJK-ja kujton fillimisht se neni 49 i Ligjit, ndër të tjera, lejon bërjen e kërkesave referuese para saj nga çdo person i autorizuar për ta bërë këtë sipas nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që lidhet apo që ka ndikim të drejtpërdrejt në punën, vendimet, urdhrat apo aktgjykimet e Dhomave të Specializuara, ose nga individë që pretendojnë shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre individuale nga Dhomat e Specializuara apo nga ZPS-ja. DHSGJK-ja kujton gjithashtu se kërkesat referuese duhet të paraqesin informacion personal si edhe një deklaratë të shkeljes(shkeljeve) të pretenduara të të drejtave the lirive individuale të garantuara nga Kapitulli II i Kushtetutës.¹³

9. Pa paragjykuar asnjë konstatim të DHSGJK-së në lidhje me statusin e ZPS-së apo të mbrojtëses së viktimave për të paraqitur kërkesë referuese lidhur me Vendimin e Gjykatës Supreme apo Vendimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, apo me pranueshmërinë e një kërkesë të tillë referuese, DHSGJK-ja vëren se nga formulimi i nenit 49 të Ligjit është e qartë se çdo afat i zbatueshëm për dorëzimin e kërkesave referuese nga ata që janë të autorizuar ta bëjnë këtë, janë vetvetiu me natyrë konkrete apo individuale, duke përfshirë edhe lidhur me argumentet e mundshme që mund të ngrihen. Rrjedhimisht, DHSGJK-ja nuk e quan të nevojshme apo në interes të efikasitetit të procesit të “sinkronizojë” afatet e paraqitjes së parashtrimeve për këtë gjë. Rrjedhimisht, DHSGJK-ja nuk është e bindur që ZPS-ja dhe mbrojtësja e viktimave kanë treguar arsye bindëse që do të përligjinin zgjatjen e afateve të parashikuara në rregullën 6 të Rregullores së DHSGJK-së.

PËR KËTO ARSYE,

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese e *HEDH POSHTË* Kërkesën e Përbashkët në tërësi.

¹³ *Shih* Udhëzuesin e Punës të Zyrës Administrative mbi Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019, neni 58.

/nënshkrim/

Gjykatës Vidar Stensland
Kryetar i Panelit

Hartuar në anglishte, të mërkurën, 25 shtator 2024
Në Hagë, Holandë